

Përdorimi i Teknologjisë për Ushtrimin e Veprimtarisë Kriminale: Avancimi i Grupeve të Organizata Kriminale dhe Pasojat në Komunitet

MSc. Klejvis Hoxha

Abstrakt

Avancimi i teknologjisë ka arritur të lehtësoi praktikat në jetën e përditshme. Normalisht kur këto teknologji përdoren pozitivisht, janë risi shumë e madhe për njerzimin. Përveç të mirave të shumta që ka, teknologjia ka disa anë të errëta, të cilat po përdoren gjerësisht nga krimi i organizuar.

Përdorimi i teknologjisë nga grupet kriminale ka sjell pasoja të rënda për popullsinë por edhe vetë shtetin. Metodrat dhe fushat ku përdoren janë të shumta, duke nisur nga hakerimi i llogarive bankare, porositja e lëndëve narkotike dhe armëve të zjarrit online, vrasje e telekomanduar etj. Ky fenomen ka shtuar nevojën për përmirësimin e legjislacionit dhe forcimin e masave të sigurisë kibernetike për të luftuar krimin kibernetik dhe krimet që ndodhin përmes teknologjisë.

Por, a mund të zhduken përfundimisht këto veprimtari? Rezultatet e deritanishme tregojnë që nuk mund të zhduket rrënjësisht por deri diku mund të parandalohet. Lufta ndaj krimin të organizuar është një sfidë që gjithnjë e më shumë bëhet më e vështirë për shtetin.

Dëmet e shkaktuara nga përdorimi i teknologjisë për veprime kriminale janë të shumta, si ato monetare por edhe njerzore. Statistikat tregojnë se përqindja e veprave penale të kryera përmes teknologjisë ka pësuar rritje të shpejtë në vitet e fundit, për shkak të avancimit të teknologjisë digjitale dhe përdorimit të internetit. Sipas disa studimeve dhe raporteve ndërkombëtare, krimi kibernetik (i cili përfshin veprime penale të kryera përmes teknologjisë) ka bërë që përqindja e veprave penale që ndodhin përmes internetit dhe teknologjisë të rritet ndjeshëm.

Fjalë kyçe: teknologjia, krimi i organizuar, krimi kibernetik, metoda parandaluese, pasoja

1. Hyrja

Në dekadat e fundit, zhvillimet e vullshme në fushën e teknologjisë kanë sjellë përparësi të mëdha për shoqërinë, por njëkohësisht kanë krijuar edhe hapësira të reja për zhvillimin e kriminalitetit të organizuar. Krimi i organizuar ka avancuar përtej formave tradicionale të veprimit, duke adoptuar teknologji të sofistikuara për të fshehur komunikimet, për të menaxhuar rrjetet ndërkombëtare dhe për të pastruar të ardhurat e përfituara në mënyrë të paligjshme. Përdorimi i aplikacioneve të koduara, manipulimi i të dhënave, mashtrimet kibernetike dhe aktivitetet ilegale në rrjetet sociale përbëjnë vetëm disa nga format më moderne të veprimtarisë kriminale që çënojnë sigurinë publike dhe rendin shoqëror.

Sipas të dhënave nga Europol dhe organizatat e tjera ligjzbatuese, numri i rasteve të kriminalitetit të lidhur me teknologjinë është rritur me mbi 60% në dekadën e fundit. Në Shqipëri, një nga rastet më të spikatura që dëshmon fuqinë e teknologjisë në shërbim të

krimet të organizuar është zbërthimi i aplikacionit të koduar Sky ECC në vitin 2021. Ky aplikacion u përdor nga grupe kriminale për të komunikuar në mënyrë të fshehtë mbi trafik droge, planifikim vrasjesh dhe pastrim parash, duke e vështirësuar ndjeshëm ndërhyrjen e organeve të drejtësisë.

Nga të dhënat e publikuara nga Prokuroria e Posaçme (SPAK), zbërthimi i Sky ECC çoi në dhjetëra arrestime në Shqipëri dhe qindra të tjera në Evropë. Ndër të arrestuarit ishin jo vetëm anëtarë të grupeve kriminale, por edhe zyrtarë të infiltruar që ndihmonin në zbatimin e këtyre aktiviteteve ilegale. Pasojat në komunitet janë të thella: rritje e pasigurisë, humbje e besimit ndaj institucioneve dhe nxitje e kulturës së pandëshkueshmërisë.

Ky punim synon të analizojë mënyrat se si teknologjia është shfrytëzuar për qëllime kriminale, të shqyrtojë rastin konkret të Sky ECC dhe të nxjerrë në pah ndikimet shkatërruese që këto praktika kanë në jetën sociale, ekonomike dhe institucionale të vendit.

2. Metodologjia e studimit

Për realizimin e këtij punimi janë përdorur dy metoda:

Metoda analizuese. Analiza e literaturave të ndryshme, shkrime dhe botime.

Metoda statistikore. Informacione statistikore nga burime të ndryshme të cilat japin një pasqyrim faktik të punimit.

1. Aplikimi i teknologjisë në veprimtarit kriminale

Shpikjet e reja teknologjike gjithnjë kanë qenë një risi për popullsinë, si pasojë i lehtëson jetesën dhe komunikimin. Disa nga shpikjet e mëdha në fushën e komunikimit kanë qenë pajisjet cellular, televizori, internet etj. Përvec se iu lehtësua jetesa popullsisë së thjeshtë, e njëjta gje ndodhi dhe për kriminelin e organizuar, ku aplikimi i teknologjisë ishte një risi për ta dhe një lehtësi për të kryer veprimtaritë e tyre. Gjatë shekullit aktual, teknologjia i ka dhënë një tjetër formë mënyrës se si po funksionon krimi i organizuar. Në vend që ta kufizoi apo të parandaloi atë, ka krijuar forma të reja dhe modern të kriminalitetit të cilat gjithnjë e më tepër bëhen të vështira për tu zbuluar nga autoritetet policore.

Teknologjia është një armë me dy tehe: ajo mund të sjellë zhvillim dhe lehtësim në jetën e përditshme, por kur bie në duar të gabuara, mund të përdoret për të kryer krime të rënda dhe të ndërlikuara. Është detyrë e institucioneve dhe e shoqërisë që të ndërjegjësohen, të investojnë në siguri dixhitale dhe të luftojnë çdo formë të përdorimit të teknologjisë për qëllime kriminale.

Format e ushtrimit të veprimtarisë kriminale me anë të teknologjisë, janë të shumta dhe gjithnjë e më shumë po zbulohen forma të reja. Një nga fushat më të prekura është kriminaliteti kibernetik. Vjedhja e të dhënave personale, mashtrimet në internet, sulmet ndaj bankave virtuale apo institucioneve shtetërore janë bërë të zakonshme. Kriminelët përdorin viruse kompjuterike, softuerë spiunues dhe teknika të avancuara për të hyrë në sisteme të mbrojtura dhe për të përfituar në mënyrë të paligjshme.

Gjithashtu, rrjetet sociale dhe platformat e komunikimit janë shndërruar në mjete të përdorura për mashtrime, kërcënime apo organizim të veprimtarive të jashtëligjshme. Njerëzit bien pre e skemave të mashtrimit online, ku identitetet e rreme përdoren për të përfituar para apo informacione të ndjeshme.

2. Format e përdorimit të teknologjisë për aktivitet kriminal

Disa nga fromat që individ të ndryshëm ose grupet kriminale përdorimin për të ushtruar aktivitetin e tyre janë:

2.1 Krimi kibernetik (Cybercrime)

- Sulme me viruse dhe malëare: Përdorin softuerë të dëmshëm për të hyrë në kompjuterët e njerëzve dhe për të vjedhur të dhëna personale ose financiare të cilat më pas I l keqpërdorin në intersin e tyre.
- Ransomware: Viruse që bllokojnë të dhënat kompjuterike ose vetë systemin e kompjuterit, e më pas kërkojnë para për t'i zhbllokuar
- Phishing: Mesazhe dhe e-maile që u dërgojnë personave të ndryshëm, zakonisht në form linku, ku në momentin që dikush klikon në të, automatikisht I vidhen të dhënat si përshembull llogarit bankare ose llogaritë e rrjeteve sociale.

Krimi kibernetik mund te klasifikohet në 4 kategori: Krim kibernetik ndaj pronës, ndaj individit, ndaj organizatës dhe ndaj shoqërisë.¹⁸

2.2 DarkWeb

Darkëeb ose ndryshe pjesa e errët e internetit, ku nëpërmjet tij shiten armë, lëndë narkotike e deri te porositja e vrajeve nga persona të ndryshëm.

2.3 Kriptomonedhat

Kriptomonedhat janë një formë e paras dixhitale. Nëpërmjet kriptomonedha janë kryer qindar mijëra mashtrime online, ku persona të cilët punojnë në call center u këerkojnë individëve të ndryshëm të investojnë në bursa fictive. Në Shqipëri, përdorimi i kriptomonedhave është i ligjshëm dhe i rregulluar nga Ligji Nr. 66/2020 "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë", i miratuar më 20 maj 2020.¹⁹ Ky ligj synon të rregullojë emetimin, tregtimin, ruajtjen dhe shërbimet e lidhura me asetet dixhitale, përfshirë kriptovalutat. Megjithatë, zbatimi i tij në praktikë ka hasur në sfida të ndryshme.

3. Përdorimi i rrjeteve sociale dhe aplikacioneve të koduara

Përdorimi I rrjeteve sociale dhe aplikacioneve të ndryshëm është një ngjarje freskë në vendin tonë, ku krimi I organizuar kryente veprimtarinë e tij nëpërmjet kësaj metode. SKY ECC ishte një aplikacion komunikimi i koduar, i përdorur gjerësisht nga organizatat kriminale për të shmangur përgjimet e autoriteteve. Pas zbërthimit të këtij aplikacioni nga autoritetet ndërkombëtare në vitin 2021, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) në Shqipëri ka ndërmarrë hetime të thelluara që kanë çuar në arrestimin e dhjetëra individëve të përfshirë në aktivitete kriminale përfshirë dhe persona që ishin pjesë e strukturave ligjzbatuese.

Komunikimet e zbërthyer nga SKY ECC kanë zbuluar një sërë veprimtarish kriminale të kryera nga grupet e organizuara në Shqipëri, përfshirë:

¹⁸ Doc.Dr. Dashmir Nasufi, Krimi Kibernetik Slide

¹⁹ <https://metajconsulting.al/cryptocurrency-dispozita-ligjore-ne-shqiperi>

- Trafik droge: Grupet kriminale kanë qenë të përfshira në trafikun ndërkombëtar të drogës, duke përdorur rrugë të ndryshme për transportimin e lëndëve narkotike nga Amerika Latine drejt Evropës, përmes Shqipërisë.
- Pastrimi i parave: Përdorimi i bizneseve fasadë, si kompanitë e makinave me qira dhe bastet sportive, ka qenë një metodë e zakonshme për pastrimin e të ardhurave të përfituara nga aktivitetet kriminale.
- Kultivimi i kanabisit: Komunikimet kanë zbuluar përfshirjen e zyrtarëve të policisë në organizimin dhe drejtimin e kultivimit të bimëve narkotike në zona të ndryshme të vendit.
- Korrupsion dhe shpërdorim detyre: Zyrtarë të lartë janë implikuar në dhënien e informacionit të klasifikuar grupeve kriminale, duke penguar hetimet dhe ndihmuar në shmangien e ndëshkimeve.

Puna masive e hutesve për zbrëthimin e SKY ECC ka qenë një hap I rëndësishëm kundër krimit të organizuar.

Gjithashtu përvec SKY ECC jan zberthyer dhe biseda të tjera në aplikacione të ngjashme si Signal, Telegram, EncroChat etj.

4. Të dhëna statistikore mbi veprimtarit kriminale të kryera nëpërmjet teknologjisë²⁰

Tabela nr 1. Statistika

| Vepra Penale | 2021 | | 2022 | | 2023 | | 2024 | |
|----------------------|----------------|------------|----------------|------------|----------------|------------|----------------|------------|
| | Te evidentuara | Te dëmtuar | Te evidentuara | Te dëmtuar | Te evidentuara | Te dëmtuar | Te evidentuara | Te dëmtuar |
| Krime Kibernetike | 413 | 35 | 417 | 165 | 672 | 211 | 971 | 84 |
| Falsifikim monedhash | 67 | 11 | 51 | 64 | 26 | 27 | 34 | 6 |

Bazuar në tabelën e statistikave më sipër, ku kemi të pasqyruar numrin e evidentimeve të veprave penale dhe të të dëmtuarve për dy vepra penale si Krimet kibernetike dhe falsifikimi I monedhave. Tek krimet kibernetike vihet re nje rritje drastike e evidentimit të veprës penale përgjatë vitit 2024. Pra janë evindentuar gjithsej 971 raste ku është kryer vepra e krimit kibernetik, nga të cilat kemi 84 persona të dëmtuar. Ndërkohë vitet si 2021 ka patur 413 raste ku si pasojë kanë mbetur të dëmtuar 35 persona, viti 2022 me 417 raste ku kanë mbetur të dëmtuar 165 persona dhe viti 2023 me 672 raste dhe 211 persona të dëmtuar. Ndërsa te falsifikimi I monedhave kemi shifra më të ulta krahasuar me veprën tjetër por jo më pak shqetësuese. Përgjatë vitit 2021 janë evidentuar 67 raste të kësaj vepre duke lënë të dëmtuar 11 persona, gjatë vitit 2022 kemi 51 raste dhe për pasojë kanë mbetur të dëmtuar

²⁰ INSTAT, Krimet dhe drejtësia penale

64 persona, në vitin 2023 janë evidentuar 26 raste me 27 të dëmtuar dhe viti 2024 me 34 raste dhe 6 të dëmtuar.

5. Rritja e rasteve të kriminalitetit të lidhur me teknologjinë në BE (2014–2023)

| Viti | Numri i rasteve të raportuara | Llojet më të zakonshme të krimeve kibernetike | Rritja krahasuar me vitin pararendës |
|------|-------------------------------|--|--------------------------------------|
| 2014 | ~180 | Phishing, malëare | - |
| 2015 | ~210 | Hakerim i sistemeve financiare, spam | +16% |
| 2016 | ~250 | Ransomëare, mashtrime online | +19% |
| 2017 | ~295 | Krime kundër të dhënave personale, sulme DDoS | +18% |
| 2018 | ~345 | Skema mashtrimesh me kriptovaluta, sulme ndaj institucioneve | +17% |
| 2019 | ~410 | Përdorimi i aplikacioneve të koduara, mashtrime bankare online | +19% |
| 2020 | 460 | Sulme ransomëare dhe spyëare (rritje gjatë pandemisë) | +12% |
| 2021 | 515 | Platforma ilegale komunikimi, pornografi e paligjshme online | +12% |
| 2022 | 580 | Krime të organizuara online, trafik digjital | +13% |
| 2023 | 620+ | Sky ECC, EncroChat, mashtrime me inteligjencë artificiale | +7% |

Tabela nr 2. Rritja e rasteve të kriminalitetit të lidhur me teknologjinë në BE (2014–2023)²¹²²

Sipas të dhënave statistikore të marra nga Eurojust dhe Europol, tregohet se në vitin 2014 u raportuan rreth 180 raste, ndërsa në vitin 2023 kjo shifër kaloi 620 raste, që tregon një rritje mbi 60% në dekadë.

Krimet më të zakonshme kanë evoluar nga phishing e malëare në fillim, në ransomëare, kriptomonedha, dhe përdorimin e aplikacioneve të koduara si Sky ECC për veprimtari kriminale të organizuar.

6. Sulmet kibernetike ndaj sistemeve të shtetit

Gjatë periudhës së fundit sulmet kibernetik u zgjeruan me një hap galopant duke etiketuar sistemet e shtetit, ato të databazës së rrogave të punonjësve, targat e makinave, lista me personat me precedent penal si dhe vjedhja e të dhënave nga sistemi TIMS.

Supozimet ishin se kishim të bënim me një sulm që vinte nga jashtë vendit por me persona të infiltruar brenda strukturave qeveritare. Por ndoshta ishin vepra të krimit të organizuar, informacione të cilat më pas do ti keqpërdornin për përfitime të shumta.

Pasoja e këtij sulmi përveç se krijuan kambana alarmi për institucionet, pati dhe në komunitet, ku disa individ ndërmorën hapin për të kryer vetëvrasje pasi kishin parë emrin në listën "e spiunave" e cila nuk ishte e tillë.

²¹ Eurojust Annual Reports (2014–2023)

²² Europol IOCTA (Internet Organised Crime Threat Assessment).

Me anë të teknologjisë, krimi i organizuar po përhap rrënjët gjithnjë e më shumë. Implementimi i pajisjeve teknologjike në veprimatrin kriminale ka bërë që të lej disa hapa pas institucioneet shtetërore.




Figura 1²³

4. Përfundime dhe rekomandime

Përdorimi i teknologjisë nga grupet e organizuara kriminale ka sjellë një revolucion në mënyrën si veprojnë këto struktura, duke u bërë më të sofistikuara, më të fshehta dhe më të vështira për t'u zbuluar nga organet ligjzbatuese. Komunikimi nëpërmjet aplikacioneve të koduara si Sky ECC apo EncroChat, përdorimi i kriptomonedhave për pastrim parash dhe transaksione ilegale, mashtrimet në internet, falsifikimi i dokumentave si dhe sulmet kibernetike ndaj sistemeve publike dhe private, kanë rritur ndjeshëm rrezikun ndaj sigurisë publike dhe rendit ekonomik.

Rritja me mbi 60% e rasteve të kriminalitetit të ndihmuar nga teknologjia në 10 vitet e fundit sipas Europol është një indikator se këto grupe janë gjith një e më shumë të përgatitura duke sfiduar kështu edhe institucionet shtetërore, e më tepër, Policinë e Shtetit.

Disan ga rekomandimet për parandalimin e kriminalitetit kopjuterik dhe perdorimin e teknologjis nga krimi i organizuar janë:

- 1) Përforcimi i kapaciteteve teknologjike të agjencive ligjzbatuese
- 2) Investim në teknologji për organet ligjzbatuese. Duke patur mjetet e fundit teknologjike arrihet gjurmimi i aktiviteteve kriminale
- 3) Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve të institucioneve
- 4) Duke u trajnuar vazhdimisht, punonjësit do të kenë më tepër njohuri rreth teknologjis kompjuterike.
- 5) Bashkëpunimi me organet ligjzbatuese ndërkombëtare
- 6) Veprat penale nëpërmjet teknologjise janë të shtrira dhe përtej kufijve, ndaj dhe bashkëpunimi midis strukturave ndërkombëtare do të sillte rezultat.
- 7) Hartimi i një strategjie kombëtare për luftën kundër krimin kibernetik
- 8) Shqipëria dhe vendet e tjera duhet të miratojnë strategji të posaçme që përfshijnë masa parandaluese, hetuese dhe ndëshkuese për krimin e ndihmuar nga teknologjia.

Literatura e shfrytëzuar

- 1) Informacione statistikore nga Instituti i Statistikave INSTAT
- 2) Eurojust Annual Reports (2014–2023)

²³ <https://images.app.goo.gl/F96eifBsXD4NRHVy7>

- 3) Europol IOCTA (Internet Organised Crime Threat Assessment).
- 4) Doc.Dr. Dashmir Nasufi, Krimi Kibernetik Slide
- 5) <https://metajconsulting.al/cryptocurrency-dispozita-ligjore-ne-shqiperi>
- 6) <https://images.app.goo.gl/F96eifBsXD4NRHVy7>